

KËRKIME GJUHËSORE

Sashenka KAMBERI

LËVIZJET KUPTIMORE DHE FIGURACIONI NË VARGJET E AGOLLIT

Ligjërimi agollian është një mozaik shumëhënës. Duke lexuar me vëmendje fjalë, sintagma, vargje e tekste poetike të poetit udhëprijës të fjalës e mendimit, hapen udhë jo vetëm për perceptime emocionore, por edhe për hulumtime e studime shkencore. Në një vështrim të përgjithshëm, mund të thuhet se poeti devollian e ligjëruesi shqiptar “zhonglon” me mjetet e strukturat e gjuhës shqipe. Në këtë hulli, kumtesa jonë ka bërë objekt studimi disa nga lidhjet kuptimore të njësive leksikore të pranishme në vargjet e Agollit, të cilat janë pjesë qenësore e laboratorit të tij krijues.

Prurjet leksikore e sintaksore na kanë ndihmuar të ndalemi sidomos në struktura poetike që i bashkon fantazia dhe mendimi i figurshëm. Ne, nuk kemi qëllim të bëjmë një analizë statistikore të figurave të përdorura, por kërkojmë të nxjerrim në pah disa nga përdorimet tipike, që ndikojnë në zgjerimin e paradigmeve semantike.

Krijimtaria e Agollit spikat jo vetëm për tematikën, por dhe për mënyrën si zgjedh dhe përpunon mjetet e ndryshme gjuhësore dhe letrare, si e riprodhon realitetin nëpërmjet figurave. Poeti mendon me figura dhe e krijon jetën në mënyrë të figurshme. Figurat në poezi shërbejnë për të ngjallur ndjenjën estetike, kanë ngarkesë artistike.¹ Ndërtesa e tij semantike e poetike nuk mund të kuptohet pa *ndjesinë e kalimeve e fluturimeve të kuptimeve të figurshme: aq të guximshme, të bukura e mbresëlënëse*². Realiteti letrar agollian shpaloset me figura e mjete stilistikore sa tradicionale aq edhe origjinale ku mund të përmendim: epitetin, metaforën, metoniminë, sinekdokën, krahasimet dhe përngjasimet (similitudat), paralelizmin figurativ e simbolin.

Lëvizjet kuptimore me anë të mbiemrit - epitet, janë të shumta dhe spikatin në vargjet e Agollit. *Mbiemri ka një pafundësi mundësish për ngjyrimet emocionore dhe shprehëse. Përdorimi në ligjërime të ndryshme bëhet tregues i kësaj dukurie veçanërisht në dhënien e informacionit vlerësues – emocionor.*³ Duke qenë se *epiteti mbart vlerësimin, vështrimin dhe veprimin e ligjëruesit*⁴, autori shpreh emocionet e qëndrimet e veta me anë të përfitesave mbiemërore të larmishme e të arrira.

Lidhja e ngushtë me vendlindjen dhe me krijimtarinë e populllore ka bërë që shkrimtari të përdorë shpesh epitete nga gjuha e gjallë. Ai përdor stilema të ligjërimit bisedor, si dhe epitete që vijnë nga ligjërimi krahinor, si: *kërcuret*

¹ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 70.

² Gj. Shkurtaj, *Pesha e fjalës*, Tiranë, 2009, f. 137.

³ V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër 1999, f. 231.

⁴ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Tiranë 1999, f. 71.

gjyshe, shtrigë botë, syzezat turke, e bukur punë e madhe, i lodhur e i lapsur, zhurmë zullumqare, dashnor i marrë, të bëjnë të sajdisur, hënë e kallajisur, ish futur gjer në palcë lanetja dashuri, i ligur faqezinj, kokëkrisur, buzëplasur (këto të fundit sipas modelit të fjalëformimit të gjuhës popullore) etj. Siç shprehet studiuesi V. Memisha në monografinë “Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë”, mjetet e realizimit të ngjyimit emocionor, gjatë përdorimit të mbiemrave në përgjithësi janë dy: me anë të *tropeve gjuhësore*, ku vendin e parë e mban epitete metaforik, si dhe me anë të *intonacionit*⁵.

Tropet gjuhësore të përfutuara nga lëvizjet kuptimore të mbiemrave në vargjet e Agollit realizohen:

1. me anë të mbiemrave të thjeshtë të nyjshëm, si: ditë e rreptë, ditë të ashpra, mendime e ëndrra të kaltra, ëndrra të blerta, plumb i nxehtë etj.

Të bie në sy gjetja origjinale që ka bërë poeti, duke i pranëvënë objektit tipare jo të zakonshme. Ai arrin që me zgjerimin e fushës tematike të mbiemrave, të përftojë trope gjuhësore origjinale, shpesh *epitete metaforike*.

2. me anë të mbiemrave nyjshëm të prejardhur, si: *njeri i përhirë, histori e pamëshirshme, djersës së ndershme, dëborës së heshtur, e ndritur ëndërr, ditë e ethshme, ëndërr të trishtuar, shpirt i çliruar, buzët e plasura, heshte e dhjamur, me mendje të prishur, pleq të rrjedhur* etj.

Shumë prej tyre janë mbiemra prejpjesorë të cilët ruajnë nuanca të foljeve prej nga vijnë dhe në më të shumtën e herës nuk mbartin ngjyresa emocionale. Figurshmërinë e fitojnë duke realizuar lidhje që i kalojnë kufijtë e të zakonshmes. Me zgjerimin e fushës tematike, këta mbiemra zgjerojnë dhe fushën semantike.

3. me anë të mbiemrave të panyjshëm, si: *ëndrra kaltëroshe, vargje rinorë, ugari qiellor, makutët lakmitarë, fletë gjelbëroshe, shpirt vetmitar, lopëz qumështore, pupla mbretërore* etj.

Në këto përdorime spikatit nuancat kryesisht librore të mbiemrave të panyjshëm.

4. me anë të mbiemrave kompozita, si: *burrat mendjelartë, zemërvrarë, ballëlartë, kokëkrisur, ahet shtatepikë, kokëshkretë, gjunjëprerë, pendëshkruar, Naimi mendjendritur, kurrizdalës vajzë* etj. Në këta mbiemra pjesa e dytë në përgjithësi është përcaktuese e së parës, figurshmëria përftohet brenda fjalës. *Lëvizjet kuptimore nuk vijnë drejtpërdrejt nga ndryshimet e fjalëve në formë e në përdorim, po këto të fundit ndikojnë tërthorazi në shndërrimet kuptimore*.⁶

5. me anë të sintagmave, si: *duart plot jetë, në vargjet mbushur mall e mbushur ëndje, shokët mbushur plagë, dyllë prej vrerit, pikën perlë të vesës, princeshë buzë ari* etj. Në këto përdorime, poeti nuk shkëputet nga figurshmëria popullore.

Agolli bën pjesë tek ata poetë që shquhen për gërshetimin e natyrshëm të vlerave tradicionale të poezisë me mënyra të reja të shprehjes poetike. Në

⁵V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër 1999, f. 231.

⁶J. Thomai, Rreth prejardhjes semantike të fjalëve në gjuhën shqipe, f. 150.

LËVIZJET KUPTIMORE DHE FIGURACIONI NË VARGJET E AGOLLIT

artikullin “*Traditë, natyrisht, por jo shtampë*” ai shprehet se *Poezia nuk do epitetet të ëmbla, por figura të fuqishme mendimi të guximshëm, detaj artistik*⁷. Siç vumë re në shembujt e mësipërm, poeti di të përdorë me vend epitetet e ligjërimeve dhe stileve të ndryshme, duke shtuar vlerën emocionale të fjalës nëpërmjet lidhjeve e marrëdhënieve të krijuara.

Si shprehje e dendësimit kuptimor në poezinë e traditës shërben **krahasimi**. Agolli si një prej poetëve të lidhur ngushtë me krijimtarinë popullore përdor dendur si mjet shprehës krahasimin. E veçantë është jo vetëm natyrshmëria me të cilën e përdor poeti këtë përftesë, por edhe larmia e befasia e përballjeve të imazheve. Krahasimi është në themel të mjetit të shprehjes edhe kur në të nuk del i shprehur gjuhësisht mjeti krahasues, duke krijuar një numër të madh mjetesh që qëndrojnë midis krahasimit e metaforës.⁸ Nën ndikimin e krijimtarisë popullore poeti përdor dendur disa metafora që kuptimisht mbeten krahasime. Në vargjet e tij gjejmë përdorime, si: vashëzat *lastare*; ndizet *prush*; me këmbë *lis të forta*; fjalën *hanxhar* e kish të mprehtë; i shkanë nëpër faqe *prush të nxehtë*; e mbajti hidhërimin *plumb* me vete; *Tym* e gjeta të vërtetën, *mjegull* trimërinë etj.

Në këto përftesa figurshmëria fitohet nga cilësia e njohur dhe e dallueshme e sendeve. Hanxhari, sipas FGjSSh është *thikë e madhe me dy presa e me majë të hollë*. Pra, këto tipare konkrete autori sipas modelit poetikës tradicionale, ia vesh një fjale abstrakte. Duke përdorur parimin e indentifikimit, zgjerohet lidhjet kuptimore të fjalës *fjalë*, duke i veshur fjalës ngjyrim stilistikor dhe ngarkësë emocionale.

Karakteristikë janë krahasimet brenda fjalës kompozitë, si: *qengj symanushaqe*; *flokargjendtë*; *ahet shtatepikë*; *nallbani qimedrizë*; *sazexhiu mustaqespicë*; *tundnin krahët mimoszat në asfaltin - pasqyrë* etj. Pra, këto nuk janë vetëm kompozita origjinale, të krijuara nga krahasimi i brendshëm, por kanë vlera të reja semantike, emocionale, shprehëse e stilistike.⁹

Në vargjet e Agollit vlerë më vete sjellin krahasimet e përngjasimit (similitudat). Duke vënë përballë dy dukuri, dy sende a dy cilësi ai hedh dritë mbi njëri prej tyre jo vetëm duke e zgjeruar përfytyrimin për të, por edhe duke zgjeruar fushën semantike të fjalës. Agolli me anë të krahasimit sjell një pasuri të madhe gjuhësore e stilistike. Krahasimet e similitudat tokësore që ai përdor janë të gjalla e të huajtura shpesh nga jeta e përditshme. Gjejmë krahasime si: *humbi në shkurret e shkresave si zogu në driza*; *në qerpikët si kallëza gruri të vashës*; *avllisë si këshjtjellë*; *reja si balonë* etj., ku krahasohen objekte konkrete të perceptueshme lehtësisht. Pra, në poetikën e tij janë objektet e mjedisit ku ai është rritur dhe ka jetuar ato që ai vendos përballë njëra – tjetrës, në bazë të parimit të indentifikimit të dukshëm të tyre.

Krahasimet që përdor poeti shpesh pranëvendosin dukuri abstrakte me ato konkrete, si: *dhemlja e shpon si gjemb*; *malli po më djeg si dru prej pishe*; në

⁷ D. Agolli, *Traditë, natyrisht, por jo shtampë*. Drita, 27. VIII. 1961.

⁸ J. Thomai, Rreth prejardhjes semantike të fjalëve në gjuhën shqipe, f. 150.

⁹ Po aty.

SASHENKA KAMBERI

gjoks një ankth si iriq; jeta më duket si lëndina; ka të tjerë që muzën si shqerrkë e ndjellin apo lidh konkretën me abstrakten si: ku rronte një princeshë si agim; shpesh herë në shtigje si djalli më hodhi; malet duken të bardhë si ëndërr etj.

Autori nuk nguron të afrojë të njohurën më të panjohurën dhe të afërtën më të largëtën. P.sh. *nata po mbillte si grurin , yjet; buzëqeshjen time ta dërgojë mbi dhe / posi pika shiu ta spërkat në ara dhe ta mbjell në brazda / sikur mbillet fara; hëna e kuqe si një mushqerrë; si mace e verdhë fshihet hëna; poema ka huqe si mushka xanxare etj.*

Lëvizjet kuptimore kanë në bazën e tyre figurat gjuhësore, që në stilistikën letrare dhe në disa gramatika janë quajtur *trope*.¹⁰ **Metafora** është një nga tropet kryesore e përfutur nga lëvizjet kuptimore dhe bartjet e kuptimit. Agolli është mjeshtër i ndërtimit të metaforave sa të zakonshme aq edhe të papritura. Ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në pasurimin e fjalës shqipe me nuanca të reja dhe kuptime të figurshme, duke dhenë një ndihmesë të çmuar jo vetëm në afrimin e fjalëve me përbërës semantikë të ngjashëm, por edhe në zgjerimin kuptimor të fjalës. Poeti përmend shumë metafora steriotipe të krijimtarisë së traditës, por guxon të krijojë shumë lidhje përtej të zakonshmes, duke realizuar përftesa befasuese.

Disa nga zgjerimet kuptimore, të cilat kanë krijuar metafora në gjuhën shqipe, të cilat i kemi hasur shpesh në krijimtarinë e mëparshme, pra metafora të zakonshme i gjejmë dendur edhe në vargjet e Agollit: *ndizet malli i parë; ç'patë që trazove mendtë e mia; dhe mua mendjen ma merr , ma përziën etj.*

Disa prej këtyre lidhjeve metaforike janë shndërruar në sintagma me kuptime të ngurosura figurative, duke dalë si togje frazeologjike.

Disa nga lidhjet metaforike befasuese në vargjet e Agollit janë: *Unë s'i lë të ma pjekin fjalën në hell; Qajnë yjet mbi trupin e rrugës së mardhur /Qajnë yjet mbi pallton time të lagur;*. Duke qenë se tropet nuk i gjejmë tek një fjalë e vetme, por në lidhjet e fjalëve me njëra – tjerën, *afrimi i fjalëve për herë të parë është një përftesë që bën përshtypje*¹¹.

Autori përveç metaforave të larmishme, duke shfrytëzuar parimin e ngjashmërisë, ka krijuar edhe shumë përftesa **metonimike**: *Kam fituar mjaft kohë e mjaft dhelpëri; Mbeta maleve të tua pa gjumë, kalojmë pranë bukurisë shpesh , hedh një gotë etj.*

Poeti, në figurat e përfytyrimit, shpesh kapërcen kufijtë e perceptimeve, duke realizuar përftesën e **sinestezisë**: *i verdhi ankth; trishtim i verdh; heshtje e bardhë; ëndrra kaltëroshe; ëndrra të gjelbra; gjumë i trëndafiltë.* etj. Stilemat e krijuar janë dëshmi e zgjerimit të paradigmës kuptimore të fjalëve të përdorura.

Poezia e Dritëro Agollit sundohet nga bota e gjallë, shpirtëzimi i mjedisit, shenjtërimi i natyrë, i arës, i tokës dhe i bagëtisë, duke përdorur figurën e personifikimit. Në poezinë popullore **personifikimi** është figurë stilistike, me anë e së cilës sendit ose kafshës i vishen tiparet e njeriut. Në vargjet e Agollit shumë

¹⁰J. Thomai, Perejardhja semantike në gjuhën shqipe, f. 158.

¹¹ Xh. Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, Tiranë, 1999, f. 140.

LËVIZJET KUPTIMORE DHE FIGURACIONI NË VARGJET E AGOLLIT

sende dhe dukuri shpirtëzohen si: *Plisave që qanin për pranverën; Hëna na bënte me sy e me vetull* etj.

Personifikimet, dëndur përdoren për të krijuar tablo apo skena alegorike nga bota e kafshëve e për të nxjerrë që andej, konkluzione që ju vlejné njerëzve. Këtë Agolli e realizon në fabulat moralizuese, si: “Breshka dhe pula”, “Mësimet e ujkut”.

*Pasurimi që i bëri Agolli teknikës së personifikimit duket, veç të tjerash, në shfrytëzimin e mjeteve nga sfera të tjera të stilit. I tillë është shfrytëzimi dhe përdorimi në poemë i atmosferës që krijon historia e një dashurie që ndesh pengesa*¹². Në poemën “Pleshti” poeti ka ndërtuar një histori të tërë mbi bazën e personifikimit ku, *pleshti me xixëllonjën ra në dashuri / dhe Plucit koka i dhemb / dhe dhembja e shpon si gjëmb*. Këtë histori pleshtash e pleshteshash të ngjashme me historinë e dy të rinjve, autori e shpalos me një tërësi personifikimesh dhe mjetesh gjuhësore, të cilat i japin efekt komik poemës.

Fjalori poetik agollian është lehtësisht i identifikueshëm dhe i pangatërrueshëm me poetë të tjerë, pasi ka një numër leksemash që dalin dëndur në gjithë krijimtarinë e tij, të cilat krijojnë lidhje nga më të ndryshmet pa rënë në përsëritje dhe në monotoni. Ato sjellin një pasuri të madhe kuptimore në gjuhën shqipe. Kështu, përveç fjalëve *tokë, arë, brazdë, baltë, ugar* etj., të cilat përbëjnë leksikon bazë në vargjet e Agollit e kanë shërbyer si fushë tematike për realizimin e shumë kuptime metaforike e simbolike, poeti realizon shumë lidhje të figurshme me aktualizimin e fjalës *gur: Mes pluhurit kam luajtur nëpër gur, Kur korriku gurët përvëlonte; Jam shpirti i një guri, ku falen qirinjtë; jemi dy gurë të rënë nga mali; Ku era e malit të bën gur* etj.

Figurat në poezi ngjallin ndjenjën estetike. Agolli e arrin këtë, duke skalitur me kujdes fjalën shqipe, duke kaluar nga lidhjet e zakonshme të fjalëve drejt lidhjeve të pazakonta dhe duke e pasuruar atë me nuanca e hijëzime të reja kuptimore. Ai e riprodhon figurativisht jetën, duke shfrytëzuar mjetet shprehëse të gjuhës shqipe, pa rënë në prangat e imitimit. Siç shprehet vetë poeti në bisedë me shokët poetë: *Unë s’imitova në rrugën time të gjatë poetë të tjerë*.¹³

Përfundimisht mund të themi se Dritëro Agolli, mbetet një nga individualitetet më të spikatur të poezisë shqipe, i cili shfrytëzoi gjuhën e gjallë të popullit për të përçuar ndjesitë dhe përjetimet personale, por i la gjuhës shqipe një thesar të vërtetë. Ai jo vetëm voli dhe përpunoi me mjeshtëri fjalë dhe kuptime të përdorura në gjuhën e gjallë, por i pasuroi fjalët me kuptime dhe kalime kuptimore të reja. Kështu, Agolli solli një pasuri të madhe në shprehësinë e gjuhës shqipe, duke rigjallëruar vlerat ekzistuese dhe duke krijuar vlera të reja.

BIBLIOGRAFI

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe. 1980.
Gjovalin Shkurtaç, *Pesha e fjalës*, Tiranë, 2009.

¹² I. Yzeiri, *Figuracioni në poezinë e viteve ‘60*, Tiranë 2011, f. 183.

¹³ D. Agolli, *Udhëtojt i menduar*, Tiranë, 1985, f. 97.

SASHENKA KAMBERI

Ilir Yzeiri, *Figuracioni në poezinë e viteve '60*. Tiranë, 2011.

Jani Thomai, *Rreth prejardhjes semantike të fjalëve në gjuhën shqipe*.

Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.

Valter Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastrë, 1999.

Xhevat Lloshi, *Njohuri për stilistikën shqipe*, Tiranë, 1987.

Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Tiranë 1999.